



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më d. 11.05.2022	
Titulli i punës 308	Nr. i protokollit 01-196

KËSHILLI DREJTUES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Kryesues i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Prizren, më 11.05.2022

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 6 dhe nenit 23 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Këshilli Drejtues i Universitetit të Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Rregullorja për Punën dhe Fushëveprimin e Komisionit për Çështje Statutare të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren .
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja e sipërshënuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Prof. Asoc. Dr. Arif Murrja

Kryesues i Këshillit Drejtues



Vendimi i dërgohet:

- Këshillit Drejtues;
- Menxhmentit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Zyrës Ligjore;
- Arkivit.



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE

**PËR PUNËN DHE FUSHËVEPRIMIN E KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE
STATUTARE TË UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" NË PRIZREN**

Prizren, 2022



Në bazë të Nenit 17, paragrafi 6 dhe nenit 23 të Statutit të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, Këshilli Drejtues, në mbledhjen e mbajtur, më 28.03.2022, miraton:

RREGULLORE PËR PUNËN DHE FUSHËVEPRIMIN E KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE STATUTARE TË UNIVERSITETIT “UKSHIN HOTI” NË PRIZREN

Neni 1

Qëllimi i rregullores

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i punës, fushëveprimit dhe aspekteve të tjera të organizimit që ka të bëjë me Komisionin për Çështje Statutare të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.
2. Përmbushja e qëllimit të kësaj rregulloreje bazohet në Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Neni 2

Fushëveprimi i komisionit për çështje statutare

1. Kjo rregullore zbatohet për organizimin, funksionimin dhe punën e Komisionin për Çështje Statutare të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Neni 3

1. Komisioni për çështje statutare i Universitetit është komision këshillëdhënës që themelohet nga KD, me qëllim të mbikëqyrjes së moszbatimit të këshillimit mbi zbatueshmërinë e dispozitave të Statutit të Universitetit si dhe akteve të tjera të nxjerra nga organet e Universitetit.
2. Fushëveprimi i komisionit nënkupton edhe kompetencat e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Në kuadër të fushëveprimit të tij, komisioni për çështje statutare, në vazhdimësi shërben si komision i përhershëm këshillëdhënës i KD.

Neni 4

Përkufizimet dhe shkurtesat

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura, me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje e kanë kuptimin si në vijim:
 - a) **Universiteti** - Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - b) **Komisioni** - Komisioni për Çështje Statutare i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - c) **Kryesuesi/ja** - Kryesuesi/ja i Komisionit për Çështje Statutare i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - d) **Personel akademik** - Personeli akademik i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - e) **KD** - Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
 - f) **Statut** - Statuti i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.



2. Shprehjet dhe shkurtesat e tjera të përdorura, që nuk janë të përcaktuara në këtë nen e kanë kuptimin dhe aplikohen ashtu siç e përcakton Statuti dhe legjislacioni në fuqi, në Republikën e Kosovës.

Neni 5

Kompetencat e komisionit për çështje statutare

1. Komisioni për çështje statutare, bazuar në fushëveprimin e tij, sipas Statutit dhe kësaj rregulloreje, ka kompetencat si në vijim:
 - a) Informon KD, pastaj përmes KD edhe Senatit dhe Rektorit për të gjitha rastet e moszbatimit të Statutit;
 - b) Informon KD, pastaj përmes KD edhe Senatit dhe Rektorit për të gjitha rastet e moszbatimit të akteve të tjera (rregulloreve) të cilat janë në fuqi brenda Universitetit;
 - c) Jep këshilla juridike lidhur me implementimin e dispozitave Statutit të UPZ, sipas nevojës për KD;
 - d) Vendos për rastet përkatëse që iniciohen për interpretimin e Statutit;
 - e) Jep këshilla dhe opinione që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të Statutit, sipas kërkesës së KD, përmes KD edhe të Rektorit dhe Senatit;
 - f) Sipas kërkesës së KD, përmes KD edhe të Rektorit dhe Senatit Paraqet këshilla mendime dhe opinione përkitazi me zbatimin e Statutit dhe dispozitave konkrete të tij, varësisht nga situatat faktike, bazuar në provat dhe kontekstin e rastit konkret;
 - g) Sipas kërkesës së KD, përmes KD edhe të Rektorit dhe Senatit Paraqet këshilla mendime dhe opinione përkitazi me zbatimin e rregulloreve që janë në fuqi në Universitet dhe, varësisht nga situatat faktike, bazuar në provat dhe kontekstin e rastit konkret;
 - h) U përgjigjet kërkesave të KD, Senatit dhe Rektorit, përkitazi me rastet që kanë të bëjnë me zbatimin e dispozitave konkrete të Statutit të Universitetit;
 - i) Sipas kërkesës së KD, përmes KD edhe të Rektorit dhe Senatit, jep mendime dhe këshilla për komisionet përkatëse në draftin e hartimit të Merr pjesë në hartimin të akteve juridike të Universitetit ;
 - j) Jep mendime dhe këshilla përkitazi me procedurën e hartimit të akteve juridike dhe rregulloreve të Universitetit;
 - k) Pranon raporte, kërkesa, ankesa nga njësitë akademike, personeli akademik dhe jo akademik dhe i trajton ato, përkitazi me zbatimin e dispozitave statutare dhe rregulloreve në fuqi në Universitet;
 - l) Merr nisma këshilluese, sipas detyrës zyrtare, që kanë të bëjnë me zbatimin e statutit dhe akteve të tjera në fuqi në universitet dhe i paraqet ato para KD, Senatit ose Rektorit, varësisht nga kompetencat statutare;
 - m) Propozon plotësimin dhe ndryshimin e rregulloreve si dhe hartimin e rregulloreve të reja, për nevoja të universitetit;
 - n) Jep propozime sipas detyrës zyrtare, për nevoja të KD, Senatit dhe Rektorit
 - o) Kryen punë dhe detyra tjera, të caktuara nga KD, bazuar në frymën e fushëveprimit dhe këtyre kompetencave.



2. Me qëllim për përmbushjes të kompetencave komisioni për çështje statutare nxjerr akte (këshilla dhe opinione) të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 6

Përbërja e komisionit për çështje statutare

1. Komisioni për çështje statutare përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë.
2. Anëtarët e komisionit për çështje statutare duhet të jenë nga radhët e personelit akademik dhe administrativ të Universitetit.
3. Të paktën një (1) nga anëtarët e komisionit janë nga radhët e Fakultetit Juridik.
4. Mandati i anëtarëve të komisionit për çështje statutare është i lidhur me mandatin e KD dhe përfundon me përfundimin e mandatit të KD.
5. Anëtar/e e komisionit për çështje statutare nuk mund të jenë anëtarët e KD ose Senatit.
6. Komisioni nga radhët e veta, me konsensus e zgjedh kryesuesin/en e komisionit.

Neni 7

Zgjedhja e anëtarëve të komisionit për çështje statutare

1. Anëtarët e komisionit për çështje statutare zgjedhën nga KD, me votim të hapur.
2. Zgjedhja e anëtarëve të komisionit për çështje statutare bëhet me shumicë të thjeshtë të votave të KD.
3. Të drejtë propozimi për anëtarët e komisionit për çështje statutare kanë të drejtë secili anëtar i KD si dhe Rektori.
4. Anëtar i komisionit për çështje statutare mund të jetë profesor nga personeli akademik i Universitetit, varësisht nga thirrja akademike.
5. Anëtarin nga administrata e propozon Sekretari i Përgjithshëm. Për t'u konsideruar i zgjedhur duhet t'i marrë votat e nevojshme në KD.
6. Me rastin e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit për çështje statutare, KD nxjerr vendim individual për secilin anëtar të emëruar.

Neni 8

Shkarkimi i anëtarëve të komisionit për çështje statutare dhe përfundimi i mandatit

1. Anëtarët e komisionit për çështje statutare mund të shkarkohen në procedurën e njëjtë në të cilën janë emëruar nga KD.
2. Shkarkimi i anëtarëve të komisionit për çështje statutare të Universitetit mund të bëhet nga KD, pas një vlerësimi paraprak dhe në rast se ai/ajo ka shkelur statutin, aktet e Universitetit si dhe Kodin e Etikës.
3. Inicimi për shkarkimin e anëtarit/es të komisionit për çështje statutare bëhet nga KD, bazuar në një raport paraprak, sipas fakteve dhe provave konkrete.
4. Me rastin e inicimit për shkarkim, anëtarit të komisionit për çështje statutare i takon e drejta për t'u dëgjuar para KD.
5. KD, me rastin e vendosjes për shkarkim të anëtarit të komisionit nxjerr vendim, të cilin ia dorëzon anëtarit të shkarkuar.



6. Anëtari/ja i shkarkuar nga KD ka të drejtë ankese, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës. Ankesa duhet të parashtrohet, sipas dispozitave të përcaktuara në Statutin e Universitetit.
7. Përfundimi i mandatit, i anëtarëve të komisionit për çështje statutare, përveç në rast të shkarkimit bëhet edhe:
 - a) Me dorëheqje;
 - b) Në rast të mungesës për tri (3) takime radhazi.
8. Në rast të përfundimit të mandatit të anëtarit të komisionit për çështje statutare, ose shkarkimit të tij/saj, në afat prej një (1) muaj KD duhet të zëvendësojë me një anëtar/e tjetër, për pjesën e mandatit të mbetur.

Neni 9

Takimet e komisionit për çështje statutare

1. Komisioni për çështje statutare për çështje statutare mban takime të rregullta dhe atë minimalisht gjashtë (6) takime brenda vitit kalendarik.
2. Komisioni për çështje statutare mban takime të rregullta dhe të jashtëzakonshme sipas nevojës.
3. Takimet e rregullta ftohen nga kryesuesi i komisionit sipas një agjende të paracaktuar.
4. Takimet e komisionit për çështje statutare mund të ftohen përmes emailit, ose përmes aplikacioneve të aplikueshme viber/whatsapp, në raste të jashtëzakonshme etj.
5. Takimet e jashtëzakonshme të komisionit mbahen sipas kërkesës së KD dhe Rektorit, sipas një kërkesë paraprake që përcakton çështjen që do të jetë në trajtim nga komisioni për çështje statutare.
6. Takimet e komisionit statutar mund të mbahen në mënyrë fizike dhe online, varësisht nga nevoja.
7. Kryesuesi i komisionit për çështje statutare përcakton rendin e ditës në mbledhjet e rregullta të komisionit.
8. Takimet e komisionit udhëhiqen nga kryesuesi dhe në rast të mungesës së tij/saj nga njëri prej anëtarëve.
9. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve të komisionit për çështje statutare, ka konflikt të drejtpërdrejtë të interesit, me rastin e vendosjes për një çështje të caktuar, duhet të ndërmarrë veprime për shmangien e konfliktit të interesit dhe duhet të tërhiqet nga vendosja.
10. Komisioni për çështje statutare, duhet të njoftojë KD, sa herë që cakton takim të rregullt.
11. Të drejtën për të propozuar pika të rendit të ditës në mbledhjet e komisionit për çështje statutare e ka edhe KD dhe Rektori. Të drejtë propozimi të pikave të rendit të ditës kanë edhe anëtarët e komisionit.
12. Gjatë mbajtjes së mbledhjes së komisionit për çështje statutare, njëri nga anëtarët e komisionit mban procesverbalin e mbledhjes.
13. Kryesuesi kujdeset për mbarëvajtjen e takimit të komisionit për çështje statutare.



Neni 10

Vendosja e komisionit për çështje statutare

1. Komisioni për çështje statutare vendos me konsensus për çështjet që paraqiten para komisionit.
2. Në rast të mungesës së konsensusit vendoset me shumicë votash të anëtarëve.
3. Vota abstenim llogaritet votë kundër.
4. Komisioni për çështje statutare vendos me votim të hapur.
5. Për çështjet që nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, përkritazi me vendimmarrjen vlejné rregullat e përcaktuara në Ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 11

Kompensimi i anëtarëve të komisionit për çështje statutare

Kompensimi i anëtarëve të komisionit për çështje statutare bëhet sipas rregullores përkatëse në fuqi për kompensimin e komisioneve që themelohen në nivel të KD të Universitetit.

Neni 12

Aktet që i nxjerr komisioni për çështje statutare

1. Me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara me statut dhe këtë rregullore, komisioni për çështje statutare nxjerr:
 - a) Opinione këshillëdhënëse;
 - b) Rekomandime.
2. Komisioni për çështje statutare, pas vendosjes së çështjes, në afat maksimal prej 30 ditëve mund të nxjerrë me shkrim njërin nga aktet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Aktet e komisionit për çështje statutare nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Neni 13

Efkti i akteve të komisionit për çështje statutare

1. Të gjitha aktet kanë efekt këshillues për organet e Universitetit.
2. Aktet e nxjerra nga komisioni për çështje statutare kanë efekt vetëm për nevoja të brendshme të Universitetit, me qëllim të vendosjes së çështjeve përkatëse në organet e Universitetit.

Neni 14

Vënia në lëvizje e komisionit për çështje statutare

1. Komisioni për çështje statutare mund të vihet në lëvizje sipas detyrës zyrtare ose përmes kërkesës së: KD, Senatit, Rektorit, Dekanit si dhe personelit akademik.
2. Kusht për vënien në lëvizje të komisionit për çështje statutare është që çështja që adresohet të bjerë në kuadër të kompetencave të komisionit që përcaktohen me statut dhe këtë rregullore.



3. Në të gjitha rastet, komisioni mund të vendos me vendim për mospranimin në shqyrtim të çështjes përkatëse, duke vlerësuar kompetencën e tij, sipas statutit dhe kësaj rregulloreje.
4. Në rastet kur komisioni vendos për pranueshmërinë e çështjes, sipas nevojës nxjerr: opinione këshillëdhënëse, mendime dhe rekomandime.

Neni 15

Roli i komisionit për çështje statutare në procesin e hartimit të akteve të brendshme të Universitetit

1. Për nevoja të Universitetit komisioni për çështje statutare mund të këshilloj apo rekomandoj iniciimin e ndryshimit dhe plotësimit dhe hartimin te akteve të brendshme të Universitetit.
2. Komisioni për çështje statutare mund të hartojë rregulloren ose aktin përkatës ose mund të jap mendim për rregulloren ose aktin përkatës, me rastin e hartimit të saj.
3. Anëtarët e komisionit statutar, sipas nevojës mund të përfshihen në komisionet profesionale, ad-hoc që krijohen nga Universiteti, me qëllim të hartimit të akteve të brendshme të Universitetit.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Anëtarët aktual të zgjedhur të komisionit për çështje statutare, vazhdojnë mandatin e tyre, sipas kësaj rregulloreje.
2. Në afati prej një (1) muaj nga miratimi i kësaj rregulloreje, KD do të vendosë përkitazi me komisionin për çështje statutare, sipas kësaj rregulloreje.
3. Kërkesat që bien në fushëveprimin dhe kompetencat e komisionit statutar dhe që janë dorëzuar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të trajtohen nga komisioni, duke u bazuar në aktet në fuqi, para miratimit të kësaj rregulloreje.
4. Kjo rregullore mund të ndryshohet dhe të plotësohet, në procedurat e njëjta të miratimit të saj.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi, në momentin e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet e tjera të Universitetit, të cilat rregullojnë punën dhe fushëveprimin e komisionit për çështje statutare.
3. Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, kjo rregullore publikohet në ueb-faqen e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof. Asoc. Dr.  Arif Maska

